

SADIK BEJKO  
**KËNGË TË SOLOMONIT**  
POEZI

---

BOTIMET TOENA



Sadik Bejko

# *Këngë të Solomonit*

*poezi*

QENDRA P.E.N. E SHQIPËRIË

BOTIMET TOENA  
Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo  
Redaktor: Çerçiz Loloçi  
Korrektore letratre: Anrila Spahija  
Përkujdesja grafike: Petrina Ago  
Kopertina:

ISBN 978-9928-235-69-5

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116;

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## Rrotullimi i planetëve

D.

Asgjë s'mund ta sjellë mrekullinë e agimit  
Veç heshtja e sigurt e lëvrimit të planetëve tej, diku.  
Kurrë s'mund ta dish se nën shtresimet thikë të territ  
Zgjuar vështrimi im rreh të cekë sytë e tu.

Mundet dhe mëngjesit s'të gjej nën kaq mjegull,  
Nën shtresat me akuj ku të fshehu nata.  
Lëvrimi heshtur i ndjenjës gjer dhe shkrirja e Arktikut,  
S'janë prerje me gërshërë fati për pritjet e gjata.



I

Thirrja e udhës





*(Kushtuar burrave dhe grave që edhe symbyllur u nisën në udhët drejt lirisë, drejt fatit.)*

Natën në nënkresë tok-tok, tok-tok...  
(çohuni!) më ushtojnë hapa:  
Kushtrim! Jam udha, nisuni!  
Nismëni gjithmonë nga e para.

1.

Dhe symbyllur nisem,  
Dhe të përplasem me shkëmb  
A të bie drejt në humnerë-  
rrugët kështu qëlluan: me hone në gryka fshehur,  
makinat - nga ato me rrota në erë.

Ulem në ndenjësë drejt, fort,  
pa çak, pa bam;  
nuk ulem, veten dorëztoj,  
kokën time të prerë  
e vë te timoni në xham.  
Si ta vësh koburen plot  
në tëmtha, nisem;  
si t'i thuash vetes: tej, tretu në erë,  
mollë e pjekur vjeshte,  
këputu me gjithë degë.

Të blatohem, rrugë:  
kalë dheu, mitër nëne  
gur vatre, gjethërim shpuzë,  
mushkëri, rrënjë  
shtrojë, mbulojë,  
kupë uji në buzë.

2.

Nisem.

S'jetoj dot pa miqtë:  
re, yje, qiell i papërsëritur  
shkëmb, hon, pyll, a një hënëz bar...  
në çast shuheni, në tjetrin merrni formë  
si hukaçjet mbi xham.

Hapje zemre si shi i ngrohtë;  
bisedë e bekuar që rrit eshtrat,  
praron e pjek të korra maji,  
në dheun tim të brendshëm  
plugim i tejdukshëm ajri.

3.

Rrugë - plaga jonë e hapur  
buzë a shtat femre  
përherë e ditur, a e shkallmuar  
çuçuritëse, a e trungët  
memece a e malluar.

... gropa andej, fushëtirë anash  
gryka lart, poshtë humnerë  
ulen male, ngrihen lugina  
diku asgjë...  
fill i ndërprerë.

4.

Na mbush, na rrit  
ne njerëzit hon dhe tunel  
hulli e udhëtimit, shpina e rrugës  
mbushulli e hapësirës pa kulm e themel.

I lëmë a na lënë miqtë bukuroshë,  
bota a shtrëngata na dalin kundër-

s'ka gjë - janë lojë e fatit,  
fati dhe preja,  
përbindësh deti dhe lundër.

5.

E marrim në sy nisjen drejt fatit  
sikur nuk jemi prej mishi  
sikur nuk vdesim ndonjëherë:  
pasionë të egra, dërrmuese  
rritur, zbrazur, tretur në erë.  
Zgjatëm kërthizën, tërkuzën e djepit tonë  
e lidhëm në rrufe, në rreze dielli që ther,  
e lamë pas si shtizë të tendosur  
... te një urë varur,  
harkuar në ylber.

I shenjtë  
vetëm çasti i nisjes,  
vetëm udhëtimi  
të tjerat:  
udhë ... rrokullisje, ngritje... erë.

6.

Zog mëngjesi  
në skelet kockash nder krahët e mëdhenj  
flatra me grimca drite të lëngësht  
të mpiksur  
si avullimi mbi lumenj.

Fli i freskët,  
mbi degë të holla kockash  
diell, erë dhe vesë veshur-  
te koha e pastër,  
te çerdhja kthehu prapë,  
te gojët e burimeve  
çurgojnë cakun ditë as natë.

Fli i fluturimit  
çelik krahët mprehur  
në cipëzën sipër lumit,  
kalitur në diell,  
kthehu në ciklin e madh,  
nga rrethi i mbyllur-

ti fluturim zogu-  
ti rrugën çaje, ti, tej e më tej del.

Truall rruge i qielltë,  
trung i zi asfalti, ebanit, mermer  
... fluturim pa cak nëpër botë  
në dhera, dete e qiej.

7.

Grykë drite pa diell,  
kanistër pa formë buke sipër-  
fytyrë e tuneltë-  
në çurgim pakohësie  
në pakufi e ngrirë  
flu mbi malet kundër dritës,  
në zbardhëllimë.

Fytyrë e tuneltë, njeri,  
eja nisemi.  
E qeshura si gotë uji në verë  
zbut me përkohësi  
ëndrra qëndrueshmërie

kur rrota puthet  
buzë më buzë me humnerën.

8.

Ti, i tunelti, vëlla me mua,  
ti i dehur për shtigje në mal,  
për nuhatje gjurmësh ti, i marrë,  
ejani, sa rrojmë  
tërkuzën e fatit ta tundim, ta shkundim fort.  
Te një balonë lart ajo varet,  
a në të tjerë litarë.

Njerëz koti, të krisur -  
mbase nga raca më e fortë -  
besojmë zemrën  
në përkohësi,  
në pakohësi gatuar  
pa shtëpi, pa kuotë.

9.

Tok-tok ... ndihen hapa... ... hapa,  
Kushtrim! Nisuni!  
Nisuni gjithmonë nga e para.

Rrugë - e gjatë sa një e shtënë plumbi  
në tëmtha,  
barabar sa një jetë,  
E shtënë në kufinj mishi, toke, ajri  
nëntokë, mbi tokë a në det-  
nisemi mik, nisemi herët,  
një gjurmë, një hap, një vragë,  
hon... tunnel... a dallgë...

10.

Ati im, zog në blu të errët,  
ti ke dritën si fëmija,  
majëmalin thikë fshehur te retë.  
Mëma ime, ke dherat, stinët, detet.  
Zëri yt më ndiell  
nga mitra e honeve te përrenjtë.

2006



II

Ora 24



## Ora 24

Akrepat e patën shëtitur orën  
Tejetej. Ja, po e prisnin ditën  
Si gërshërët gjethen nga dega.

Ca zëra:

Ku, ku je? - më thërrisinin.

Lëvarur isha te bryma a te rrapet  
Te thëllimi që shtie gjethet  
E rrjep gëzofin e bishave.

Tek shuhen gjurmë ujku mbi borë  
Ku lëkurat zhvokshen nga trungjet  
E nga shpina e gjarpërinjve.

Mpiksja e ujit në akull, mpiksja e ditës  
Në muzg, aq tejdukshëm,  
Më patën tëhollur si brumin në petë.

Ku, ku je? - thërrisinin.  
Tegela gjalmi të natës  
Me gjilpërën e brymës

Më qepën, mbyllur në gjethe.

Ndër rrathë përbrenda trungut,  
Në rrjetë zifti vrimash të zeza...

... Një eklips gjysmëhëne në kokë

(Ku, ku je?)

... E dot s'përgjigjesha.

# Ujku

Te mali, te mjegullat, te dimrat,  
ndër ujq që netëve ulërijnë,  
kam radhën: vë kujën.  
Jam unë ujku tani.

Larg nga bijtë,  
nga kaproj e mëshqerra  
në flakë të sqfurt rrufeje, në uri  
netëve, ulërij.

Ngulur pyllit si gjilpërë,  
ulërima (si unë) veshët lart,  
bishtin në shalë,  
shket rrafsh pyllit në brymë.

Uuuu...!  
zbret hejeve të akullit  
te dhoma me zjarr  
i futet fëmijës në gjumë.  
Ai në lebeti: ati im,  
ujku, ujku, ku je ati im?

Pas vitesh ky fëmija,  
(s'e harron atë natë),  
i thinjur si një pyll me borë,  
në mungesë, në hungërimë  
në mug, mjegulli,

Ulërin.  
Ka radhën  
tani ujku është ai.

Ditëve  
kujën time ka të ngulur në grykë -  
nuk e dëgjon njeri.

Natën (ati im, ati im)  
si në fëmijëri  
pa zë këlthet: po ku je, ati im?

Hapësirat para i kyçen në cingërimë.

Lart te mali, te mjegullat  
një tjetër ulërimë...

## ... nën dhunën e dritës

Herë-herë shoh ëndërr  
një bibliotekë ndryrë nëntokë.  
Nga një tërmet  
nuk ia gjen dot hyrjen,  
skedat, raftet, librat.

Truri një njollë, një varr  
në bulbin e zambakut të shkëmbit  
terur rendi i librave, i kujtesës,  
oraret, largësitë shkrirë.  
Ca fije të përçojnë në plasa dheu  
nën flokë kafkës krisur, çarë.

Korja e trurit  
a syri i përplasur  
gjethojnë njolla,  
mbi ekran pika gjaku,  
hije vallëzojnë  
mbi gojë trarësh të kalbur  
drejtuar në hone.

Dhuna e ditës në periferi të rrethit  
fshik e verbon hijet

dridhshëm me milingonat rendin  
të gjejnë krisën nën tokë  
jashtë stuhisë.

Trandja e tërmetit,  
përçartje përmbysëse  
platitje nate burimeve që shteren,  
në thyerje vargjesh shkëmbore,  
lumë që humb ngjyrat...  
as qartësi, as kthjellim.

I mbahem territ,  
rrethit blu ku syri pikë e vrimë  
me jashtësitë shtypur e shfytyruar  
si nën tornado.

Kufijtë, vijëzimet e botës  
pelte, pluhurimë,  
tog pluhuri me imazhe.

Në bërthamë të errësirës,  
veç mesit,



qendra me pak dritë...  
një njollëz.

Përtej  
pikës së mortit  
në ç'largësi shkartisur, vidhisur  
vallë dhe ti  
fari i territ, dritë shkëmbit të molit  
dhe ti nën këmbë tornadoje,  
nën thundra elefantësh në rendje?

Dil  
dil nga  
elefantë që më rendin në tru  
merr e gjej  
bregun tënd të fatit,  
dritat, ujin  
dhurata, thonë, nga hyjnitë.

Blanat, hije muzgu, pa vijëzime, të kipsit tim,  
atje tej zgjatur,  
i vesh si rrobën çdo mëngjes

i mbart si kufomën nëpër dritë  
e shtyhem pas  
prej dhunës së dritës në periferi të terrta.

# Mos më lexo në mbrëmje, Magdalini

*Bashkë me të kryqëzuan dy vjedhës...*

Nën qiell pus fundon Tirana. Ngrijnë  
lulekumbullat tek bëjnë të çelin.  
Dimri, penduar që ende s'ka marrë hak,  
bën të ikë e rikthehet më i vrazhdë.

Trishtuar jam, Sulamith, ajmé Magdalini,  
kënga ime e këngës... mbretëria ime...  
turtujt pa qiej, pa zë, pa thërrmi.

Tek udha... një njeri po e mbillnin në dhé,  
Ofshet e tij ende dëgjoheshin mbi tokë.  
E rrihnin sipër dheun me shputat e këmbëve  
ta fundonin me thellë se kufomën.

E ky dimër shkon e kthen me një peng,  
(në mbrëmje, jo, mos më lexo Magdalini).  
Ajër i therur... acar, zogj me akuj në sqep.

E mbjellin, po atë njeriun s'e dashka dheu.  
Të gjallë e hedhka tej jashtë truallit

jashtë hapave të atyre që e shkelnin.  
Ai njeriu e përbuzka dheun.

Sulamith, lexomë kur të them të dua.  
... jo në mbrëmje, Magdalini. Pa plang jam,  
akullin strehë ndaj, tok me hajdutë rruge.

Një mijë, dy mijë vjet ajo kufoma si ujë  
Ndal e zbraps dhe hedh në humnerë  
rrasën e vdekjes. Mbi ata sipër ngjallet,  
me vdekje vdekjen e shkel.

Nuk do ta gjesh te shpella, Magdalini.  
As mua. Në vrimat e gozhdëve  
që më nguli dimri nuk do futësh gishtin.  
Nesër lulebajame do shkunden nga degët.

... Do të shkundet nga akujt dhe endacaku  
Me verën e natës i dehur, me një thes  
lulebajamesh nën xhaketë fshehur.

# Loja

Jam ulur në fundin e fundit tim  
te një amforë e njomë balte.  
Mjeshtri nën tryezë luan gishtat.  
Thelloma hupët hapet  
e flakem pa adresë  
letër poste në kuti fshati,  
në të humbët Tibet a Siberi.

Mjeshtri me shputa lot çikrikun.  
Në valixhen pa fund hedhur,  
firuar e rrjedhur gjithëkundit  
as hiri nuk i mbeti rrugës.  
Fakir indian me fyell e qyp  
qenkam kthyer në shtëpi,  
në sheshe flirtoj me kobra.

Fund amforës me baltë të njomë  
(Mjeshtri në hije lot çarkun)  
lidhur pisk nga kobrat,  
buzët e holla,  
belin prej gruaje të qypit lakmoj.  
Plot helmët e thellë në gëzim jam

si bujk gjer te gjunjët ngjeshur  
me drithin e ri te lëmi.

Rrak e shtrak çarkun...